

Tema: Njohja e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm
Strategjitë për parandalim

Pjesa e parë: Shpjegim termi

Pjesa e parë e takimit orientohet drejt shpjegimit të termit, me qëllim dhënien e informacionit të saktë:

Ekstremizmi i dhunshëm lidhet me ato besime dhe veprime që mbështesin ose përdorin dhunën e cila justifikohet për shkak të disa pikëpamjeve politike shumë të ashpra (radikale), ideologjike dhe/ose fetare. Pikëpamjet e ekstremizmit të dhunshëm mund të shfaqen në një sërë çështjesh, duke përfshirë dhe ***marrëdhëniet politike, fetare dhe gjinore***. Asnjë shoqëri, komunitet fetar ose pikëpamje botërore nuk është immune ndaj një ekstremizmi të tillë të dhunshëm.

Ekstremizmi i dhunshëm shkon përtej dhunës në familje dhe nuk lidhet vetëm me pjesën fetare. Për këtë arsye, është e nevojshme njohja me detaje e këtij fenomeni.

Pse është e rëndësishme që gratë ta njohin EDH?

Përfshirja e të rinjve në grupe ekstremiste është një shqetësim në rritje. Çdo fëmijë apo iri mund të jetë i ndikuar nga grupet ekstremiste, edhe pse ka faktorë që mund të bëjnë që disa fëmijë dhe të rinj të jenë më të rrezikuar se të tjerët.

Është shumë e nevojshme që si prind, por edhe si anëtare shumë të rëndësishme të shoqërisë ta njihni këtë fenomen dhe të mundohemi të gjithë së bashku për parandalim dhe raportim. Ndërkohë, ne e dimë se gratë dhe vajzat, janë kryesisht kujdestarët parësore në familje dhe ***qëkujdesen më së shumti për të gjithë anëtarët e tjerë***. Për këtë arsye, për shkak të kontakteve më të afërta, gratë dhe vajzat mund të jenë më ***vigjilente për shenjat paralajmëruese*** që mund të kenë familjarët e tyre dhe që janë këmbanë alarmi për përfshirjen në ideologji dhe grupe ekstremiste. Gjatë bisedës, ne do të shpjegojmë edhe disa shenja tipike, që mund t'i evindetoni.

Cilat janë shenjat e hershme paralajmëruese të ekstremizmit?

• Si prind, duhet të dini se individët dhe grupet me pikëpamje ekstremiste përdorin ***internetin dhe mediat sociale*** për të përhapur ideologjitë e tyre. Fëmijët shpenzojnë shumë kohë në internet dhe kjo i ka bërë më të ndjeshëm ndaj ekstremizmit. Për këtë arsye, ne ju sugjerojmë që gjatë gjithë kohës të mbikqyrni se çfarë fëmija juaj bën ndërkohë që përdor telefonin apo kompjuterin. Gjithashtu, rekomandojmë që përdorimi i internetit të jetë sa më i pakët. Por, duket se për shkak të situatës së pandemisë, nevoja ndaj teknologjisë është rritur akoma më shumë. Për këtë arsye, ***rritja e vigjilencës dhe mbrojtja e fëmijëve*** nga rreziqet e lidhura me internetin duhet të jetë akoma më e madhe.

• ***Ndryshime humori të vazhdueshme*** dhe të shpeshta, që nuk janë tipike dhe nuk justifikohen me një situatë specifike të njohur nga ju.

• ***Humbje e interesit në*** mënyrë të papritur dhe drastike nga gjërat qëi kanë bërë me shumë dëshirë kohë më parë

• Largim dhe tërheqje nga ***aktivitetet e mëparshme, familja apo miqtë***

• Krijimi i ***miqësive të reja*** që ndikojnë jo mirë tek personi që është angazhuar në veprime ekstremiste

• Ndryshime të papritura dhe shumë të dukshme në ***pamje ose në veshje***

• Ndryshime të lidhura me mënyrat e të ***ushqyerit dhe të fjeturit***

• Ndryshime të lidhura me ***gjendjen financiare*** (duke kursyer apo duke shpenzuar para në mënyrë të papritur)

• Ndryshimet përsa ***ipërket lidhjeve më të tjerët***, duke u sjellë në mënyrë të çuditshme, shpesh herë dhe agresive, mosdëshirë për të komunikuar dhe bashkëvepruar me të tjerët, mosdëshirë dhe refuzim për të respektuar rregullat dhe autoritetin.

• Të folurit në mënyrë të ndarë ***'ata dhe ne'***, apo me terma përçmues ndaj të tjerëve që janë të ndryshëm, duke refuzuar të merren me ta ose duke abuzuar ndaj tyre

- Shprehja e *pikëpamjeve ekstremiste apo mbështetja* e pikëpamjeve të tilla, duke justifikuar veprimet e tyre, duke mbështetur mesazhe ekstremiste, akte apo mjete të dhunshme;
- *Interesimi i papritur* për politikën e brendshme ose të jashtme, duke shfaqur mosbesim dhe irritim ndaj politikëbërësve;
- Përdorimi i *literaturës dhe imazheve ekstremiste*;
- Vendosja e kontakteve me persona që bëjnë përzgjedhje në *organizata ekstremiste*, duke u bashkuar ose duke u përpjekur për t'u bashkuar me organizatat ekstremiste;
- *Përpjekje për të përfshirë* dhe për të bindur të tjerët për tu përfshirë në grupe ekstreme
- Të qenët i *fshehtë dhe ngurrues* për të diskutuar aktivitetet, vendndodhjen, bashkëpunëtorët;
- Kalimi i kohës së tepërt *në internet ose në telefon*, duke ndryshuar identitetin online, duke zotëruar telefona celularë ose pajisje të ngjashme dhe duke i mbajtur ato private në mënyrë strikte.

Si mund t'i mbrojmë fëmijët dhe të rinjtë?

1. Ndani informacion

Informimi është një nga strategjitë kryesore që mund të parandalojë ekstremizmin e dhunshëm. Për këtë arsye, diskutoni me fëmijët, të rinjtë, gratë dhe vajzat, si dhe me gjithë komunitetin për këtë fenomen, rreziqet dhe pasojat që sjell pjesëmarrja në grupet ekstremiste.

2. Bisedoni me fëmijët dhe të rinjtë për aktivitetin e tyre në internet

Shpesh fëmijët nuk i gjykojnë si të huaj njerëzit që kanë takuar në internet përmes rrjeteve sociale dhe lojrave në internet - ata janë vetëm miq në internet. Tregojuni se është shumë më e lehtë që njerëzit të gënjëjnë në internet sesa në jetën reale. Idealja është që të jeni miq me fëmijën tuaj në mediat sociale, por nëse ata nuk kanë dëshirë, atëherë kërkojini një shoku ose një anëtar të familjes që të provojë të jetë miku i tyre. Kërkojuni t'ju tregojnë disa nga faqet e tyre të preferuara.

3. Njihni më nga afër miqtë e fëmijëve dhe të afërmve tuaj

Njihni shokët dhe shoqet e fëmijëve tuaj. Pyetini ata me detaje se si i zgjedhin miqtë, aktivitete që bëjnë me ta, si dhe vazhdimishtmbiqyrini se ku shkojnë.

4.Realizimi i aktiviteteve të përbashkëta

Është shumë e rëndësishme që të kaloni kohë cilësore me fëmijët dhe të rinjtë. Duke qenë më pranë jush, fëmijët dhe të rinjtë e kanë më të vështirë që të gjejnë ndjenjën e përkatësisë në organizata ekstremiste, sepse kanë lidhje të shëndetshme me ju. Gjithashtu, për çdo problem, komunikimi do të jetë më i thjeshtë.

5. Diskutoni mbi paqen dhe tolerancën

Diskutoni me fëmijët tuaj mbi vlerat e paqes, tolerancës dhe zgjidhjes së shëndetshme të konflikteve. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që ju të jeni vetë një model i tillë për fëmijët dhe të rinjtë.